



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.124/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Hasan Shala dhe Nenad Laziq anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Podujevë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Podujevë, për shkak të vendosjes se banerëve mbi rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 05.06.2014, mori këtë:

#### VENDIM

**Miratohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Podujevë, kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Podujevë i shqiptohet dënim i më gjybë në vlerë prej 5100 (pesë mijë e njëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

#### Arsyetim

Me datën 04.06.2014 subjekti politik LDK dega në Podujevë ka parashtruar ankesë në PZAP me të cilën pretendon se me datën 03.06.2014 në ora 10:15 mbi rrugën publike “Zahir Pajaziti” dhe “Skënderbeu” në Podujevë, subjekti politik PDK ka vendosur banerat të kandidatëve të tyre për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe sloganin e subjektit të PDK-së. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bëre shkelje e nenit 4 paragrafi 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore nr.11/2013 Kodi i Mirësjelljes për subjektit politikë, mbështetësit e tyre dhe kandidatët. Me këtë rast parashtruesi i ankesës si dëshmi ka bashkangjitur disa fotografji.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe 122 paragrafi 1 pika a), subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) e informoi dhe Urdhëroi që të ndërmarr masat përmirësuese lidhur me ankesën më datën 04.06.2014, dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj kësaj ankesë deri më datë 05.06.2014 në ora 09:00.

Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, nuk mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se banerat e kandidatëve për deputet nga radhët e subjektit politik PDK janë të vendosura mbi rrugët publike , e që është në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fonave të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktivitetave të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i konstatoi nga shkresat e lëndës se posterat e kandidatëve për deputet nga radhët e subjekti politik PDK, janë vendosur mbi rrugë publike që është në kundërshtim më nenin 33 pika (b) të LZP-së. Subjekti politik PDK edhe pas marrjes së urdhrit nga PZAP-i, për përmirësimin e shkeljes, subjekti në fjalë nuk e ka ndërmarr asnjë veprim lidhur më evitimin e shkeljes e cila çështje ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar. Prandaj bazuar në nenin 3.2 të Rregullës nr.01/2012 "Për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave", si dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë**

Anr.124 /2014 më datën 05.06.2014.

Kryesuesi i Panelit

Xhevdet Abazi

PZAP, nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim. sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*